

KOSOVARJA

Ballina: Merita Merja

**A më i vjetër
plisi a flamuri**

**Politikanët
na bënë
pikë e pesë**

**Luftëtari:
As kështu
nuk jetohet**


**Grimerja
Merita Merja**
*një femër e fortë,
gjithnjë on top*

**Miesere Skenderi
vulos suksesin
në fushën
e së bukurës**

**Pse e vendosa
foton time
te njerëzit
e vdekur**

**Më donë
edhe pse
nuk jam
e virgjër**

**Politikanët
e këngëtarët tanë
që u martuan
dy herë**





DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË



+383 44 206 586



www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, nje game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; "mirage", "azuvi", "ecoceramic"

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.




BREZOVICA HOTEL & SPA

info@brezovicahotel.com

www.brezovicahotel.com

049 30 10 30, 045 60 70 70





Ku është Luan Jaha?

Aktori Luan Jaha është shumë i njohur dhe i pëlqyer nga publiku i gjerë. Ka luajtur në rreth 50 shfaqje teatri, në filma të metrazhit të shkurtër dhe të gjatë. Dhe, ndonëse ka luajtur dhe vazhdon të luajë në projekte shumë serioze, Luan Jahën edhe më tej e identifikojnë me rolin e Dajës Skender, nga seriali “Familja

Moderne”.

“Kam pasur role edhe më të mira, por popullaritetin e kam arritur me Dajën Skender, në serialin “Familja Moderne”, ka thënë shumë herë. Njëkohësisht, është profesor i aktrimit në Fakultetin e Arteve në Prishtinë. Është alergjik ndaj politikës dhe nuk e sheh veten kurrë në politikë...



Me çfarë merrej Mentor Haziri para se të bëhej këngëtar?

Se Mentor Haziri është këngëtar i mirë, kjo është dëshmuar prej vitesh. Por, a e keni ditur se vite më parë ka qenë pingpongist profesionist?

Ai ka luajtur shumë mirë ping-pong dhe këtë talent e ka trashëguar nga babai i tij, që ishte pingpongisti i parë në Ferizaj.



Ku, si, çka?

Pse Mc Kresha nuk u bë mjek?

Mc Kresha ka bërë muzikë shumë vjet përpara se të bëhej i famshëm. Suksemi i erdhi me këngën “Lej fllëshat”. Mc Kresha është ndër reperët shqiptarë me më së shumti bashkëpunime. Ka bashkëpunuar me shokun e tij Lyrical Son, me Dafina Rexhepin, TDS, Leonora Poloskën, Aurela Gaçen, Kidën etj. Ka disa albume muzikore... Megjithatë, a e keni ditur se prindërit e Kreshës nuk donin që ai të merrej me muzikë?

Mc Kresha i ka prindërit mjekë, andaj dëshironin që edhe djali i tyre ta vazhonte traditën. Megjithatë, Mc Kresha vendosi ta dëgjonte zemrën e tij, të merrej me muzikë.



Grimerja Merita Merja *një femër e fortë, gjithnjë on top*

Se i zbukuron e transformon nuset - dihet, se këngëtares, artistet e modellet i bënë të shkëlqejnë - edhe kjo dihet. Por, Merita Merja është shumë më tepër se kaq, është artistja multi-dimensionale që ka lindur për të bërë gjëra të mëdha dhe për të mos u ndalur kurrë...

Meritë, si ka nisur ky vit për ty?

- Ky vit ka qenë një fillim i mirë dhe i mbarë jo vetëm për familjen time, por edhe për punën që unë bëj. Uroj që viti 2022 të vazhdojë kështu siç ka nisur, me mbarësi.

Jeni biznes-women e suksesshme dhe shembull për gratë e tjera. Çka u ka ndihmuar të arrini këtu ku jeni?

- Kjo është një pyetje së cilës nuk mund t'i përgjigjem me disa fjalë, por që po mundohem ta përmbledhë. Të jesh femër dhe të arrish suksese, është pak e vështirë në ditët e sotme. Suksesi im ka ardhur hap pas hapi,

gradualisht, e kjo falë përpjekjeve dhe ambicieve të mija.

Familja ime ka qenë shumë suportuese ndaj meje, për çka u falënderohem gjithmonë. Dhe, më duhet të them: Zoti më ka ndihmuar gjithmonë...

A ka ndonjë formulë suksesi për të pasur një pozicion të mirë në botën e biznesit?

- Edhe nëse do të kishte një të tillë, sërisht formula ime do të ishte kjo: punë, vullnet, sakrificë dhe dëshirë për ta bërë më të mirën në atë çka unë di dhe ofroj, duke u munduar që të jem sa më pranë perfektes.

Si femër është më e lehtë apo më sfiduese për t'ia dalë mbanë në jetë dhe punë?

- Nuk mund të them se është e lehtë, por edhe e pamundur nuk është. E pamundura nuk ekziston për mua. Kjo vlen në aspektin e punës. Sfidat më pëlqejnë dhe i pranoj, pasi i provoj aftësitë e mija për t'ia dalë mbanë.

Sa i përket jetës, ka shumë gjëra të papritura dhe jo çdo gjë mund ta kontrollojmë apo ta kemi vetë në dorë.

A ke një muzë, dikë që të frymëzon?

- Nuk është vetëm një, meqë janë shumë faktorë që më frymëzojnë të eci përpara



dhe të shpalosë më të mirën. Gjithë jetën time kam qenë dhe do të jem femër e frymëzuar nga e bukura, që është muza ime kryesore, madje jo vetëm në fushën time, por edhe jashtë saj.

Njiheni si makeup artiste, parukiere dhe stiliste. E lindur për art apo?

- Po, është e vërtetë. Kam filluar si parukiere dhe stiliste dhe më pas e kam zgjeruar biznesin, duke qenë se jam një njeri me kreativitet dhe më pëlqen të eksploroj gjëra të ndryshme, të cilat sërish janë brenda fushës sime. Nuk mund të them nëse kam lindur për art, apo jo. Këtë po e thoni ju...

E keni menduar, ndonjëherë, se do të jeni Merita Merja që njerëzit e njohin sot?

- E kam ditur gjithmonë, meqë jam njeri që kam shumë vetëbesim te vetja dhe, gjithashtu, në aftësitë e mija. Modestinë e lëmë me një anë...

Kur dhe si u vulos suksesi juaj në fushën e së bukurës?

- Nuk është se ka qenë një moment specifik. Njerëzit që më njohin nga afër e dinë që mua nuk më rri shpirti rehat nëse nuk nxjerr diçka të re, të veçantë. Me këtë nënkuptoj se nuk mund të rrijë në vendnumëro, meqë kam shumë ambicie në kuptimin e mirë fjalës. Synoj më të mirën dhe gjithmonë për risi. Dhe, kur puna bëhet me pasion e dashuri, suksesi vjen vetë...

Kemi parë dhjetëra transformime të nuseve. Ç'thonë kur e shohin veten?

- Në çdo sezon kemi me qindra nuse, të cilat vijnë në sallonin tonë dhe na e besojnë neve pamjen e tyre në ditën më të rëndësishme. Përkushtimi ndaj tyre është parim. Disa vijnë me ide të qarta, disa nuk na përzihen në idetë tona. Sido që të jetë, përherë dalin tepër të kënaqura dhe falënderuese. Disa mahnitën, të tjerat qajnë nga emocionet e shndërrimit që u bëjmë.

I duam shumë klientet tona dhe vend të veçantë kanë nuset.

Punoni edhe me shumë VIP-a. A ka bërë kjo që të jeni akoma më e kërkuar dhe e njohur?

- Një pjesë e mirëfilltë e klienteles time janë VIP-a, ku hyjnë këngëtare, avokate, aktore etj. Sidomos në Dubai, pas hapjes së sallonit

tim atje, klientela është e përbërë nga emra shumë të njohur. Evenimente të ndryshme na kanë bashkuar së bashku për takime biznesi dhe bashkëpunime nga më të ndryshmet. Sigurisht që publikimi i tyre bën punën e vet, por unë nuk e kam parë kurrë në këtë aspekt. I kam miq të mirë e që i respektoj dhe më respektojnë.

A po vazhdoni të jeni me punë në Dubai?

- Jam duke e shijuar nektarin e punës sime në Dubai dhe jam shumë e lumtur për arritjet e mija atje, edhe pse ende është vetëm fillimi. Pa dyshim, duhet të punojë shumë dhe të vjelë frutat e punës, për çka më ka ndihmuar Zoti të jem këtu ku jam.

Jam besimtare dhe mirënjohëse ndaj Zotit për gjithçka që kam arritur deri më tani...

A po vazhdoni të mbani masterclass në Dubai?

- Sa i përket masterklasit kam një surprizë për të gjithë. Akoma nuk mund t'u tregoj, por diçka e bukur po përgatitet si në Dubai, gjithashtu, edhe në Shqipëri. Masterklasi në Dubai do të jetë me një person, i cili ka shumë sukses dhe që është miku im më i mirë prej vitesh. Emrin nuk ua tregoj, po u lë të pritni edhe pak...

Keni botuar edhe libër për botën e së bukurës. Si është pritur?

- Është libër që e kam shkruar me shumë dashuri dhe aty ka gjithçka që njerëzit duhet të dinë për fushën time. Në libër çdo njohuri e kam shpalosur në formën më të mirë të mundshme. Nuk kam mbajtur asnjë sekret për vete. Libri është pritur me shumë interesim dhe ka pasur shumë sukses. Jam falënderuese, pa fund...

Cili është produkti juaj i personalizuar që u ka përmbushur më së shumti?

- Produkte të personalizuar janë disa, e ai që më ka përmbushur mua si individ është brendi im, të cilin e kam lansuar vitin e kaluar me emrin "Glam By Merita". Brendi përfshin Paletën dhe xixat që mbajnë emrin tim.

Ka pasur rekord shitjesh, e që, sinqerisht, nuk e prisja, ndërkaj blerësit ishin nga e gjithë bota. Kam qenë dhe jam ende shumë e emocionuar për brendin tim.

Nderim Neziri



A jemi ata që ishim dikur...



Politikanët na bëjnë pikë e pesë!

Politikanët tanë, për një të shkretë karrige, duan ta hanë njëri-tjetrin, e harrojnë se në xhehenem ka vend për të gjithë!

Heu, more burrë, na hyri dreqi në bark dhe duam ta hamë për së gjalli njëri-tjetrin! Jemi ndarë nëpër grupe politike dhe të gjithë ata që mendojnë ndryshe i quajmë tradhtarë! Ç'po ndodh, kështu, me ne, o Zot?! Ishte një kohë ku aq shumë e donim njëri-tjetrin, aq shumë e ndihmonim

njëri-tjetrin, aq shumë e nderonim njëri-tjetrin, sa edhe kafshatën e gojës e ndanim përgjysmë me tjetrin...
Vinin para e ndihma për familjarët skamnorë, pa e ditur as i zoti i shtëpisë nga vinin dhe kush ua dërgonte...
Me rëndësi ishte që askush të mos vuaj urie, askush të mos heqë për kafshatën e gojës...
Dhe, ata që dërgonin ndihma, nuk donin t'u përmendej as emri, as firma, as fshati a qyteti nga ishin...
Nuk pranonin t'u thuhej as falemin-derit. E ndienin obligim njerëzor, obligim kombëtar...
E tash?
Ku treti ai obligim njerëzor?!

Ku treti ai obligim kombëtar?!
Secili mundohet të grabisë nga tjetri!
Secili mundohet të ketë vetëm për veti!
Të ketë shumë, sa më shumë...
E, skamnorët e shkretë, invalidët dhe të tjerët që nuk kanë ku të punojnë, i sheh sa te njëri kontejner e sa te tjetri, për të gjetur ndonjë kafshatë buke, që të mos vdesin urie...
Eh, të mjerët ne, ranë politikanët dhe na sorollatën në këtë gjendje, duke na ndarë nëpër grupime politike për realizimin e synimeve të veta, me qëllimin e vetëm që të pasurohen sa më shumë, pa hesap!

Isa ILAZI

SHPEJT I HARRUAM! PSE?

Janar i këtij motmoti. Çuditërisht, janari është muaji në të cilin kanë vdekur njerëzit, personalitete të mëdha të kombit tonë, të historisë sonë. Por, në këto raste, të shkon në mendje pyetja: Pse disa emra të njohur nuk përkujtohen fare? Madje, as në përvjetorët e tyre të vdekjes!

EH, MORE ZEKERIA CANA!

10 janar i këtij motmoti. Përcjell portalet tona të kësaj dite. Asnjë fjalë për prof. Zekeria Canën në shenjë përkujtimi. Në mbrëmje përcjell edhe ekranet televizive, lajmet... As ato - asnjë fjalë për profesorin e nderuar, burrin e madh të Kosovës. Virtutet e profesor Canës do të kujtohen dhe do të nderohen përherë nga qytetarët e Kosovës - thoshin pushtetarët në telegrame ngushëllimi ato ditë kur ai vdiq. Por, nga ato ditë e sot, profesor Cana sikur u harrua... U harrua njeriu i cili në dy dekadat e fundit të shekullit XX qe bërë simbol i rezistencës ndaj dhunës, përndjekjeve, tmerreve dhe vrasjeve të shqiptarëve. Me këtë çast, se ç'më kujtohet marsi i përvjetorit të parë të pasluftës i rënies së komandantit legjendar Adem Jashari, që mbahej në Prekaz. Dhe, derisa atje mbahej organizimi, takohem me profen në kafenenë "Bagrem". Në sytë dhe fytyrën e tij lexohej qartë se ishte i pa disponuar, i zhgënjyer, i rraskapitur... "I thyer jam sot, Gani Dili", më drejtohet me fjalët e para, thuajse e kuptoi shqetësimin tim. "Sot, në përvjetorin e parë paslufte, e që me duart e mia e lëshova në dhe Ademin, unë atje mungoj". "Pse?", e pyes. "Nuk më kanë ftuar!" Po këto fjalë m'i thotë edhe në natën e kremtimit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, teksa liderët dhe shumëkush cakërronte gotat në emër të Pavarësisë. U habita kur dëgjova fjalët e profesorit nëpërmjet telefonit se as në këtë solemnitet nuk e kishin ftuar... Por, pavarësisht nga këto, emri i profesor Canës mbetet i përjetshëm në historinë e Kosovës, sepse edhe Ai e ka hisen e vet. Ai edhe në kushtet e regjimit serb krijoi e lartësoi dinjitetin e shqiptarit... Andaj, a nuk është turp të mos kujtohet ky vigan i historisë shqiptare, ky patriot i madh që shkriu gjithçka për popullin e Kosovës?! Ai, kush tjetër e meriton të përkujtohet? S'ka nevojë të përmenden daljet e tij në ballë të demonstratave kundër regjimit serb, as në ballë të tubimeve për Paqtimin e Gjaqeve krah Anton Çettës, as në konferencat e shtypit krah Ibrahim Rugovës, e as për 39 burgosjet e tij...

EH, MORE SHKËLZEN ZHUBI!

Unë Lekë Zhubin e kisha njohur si fytyrë dhe si luftëtar i UÇK-së nga pak ndeja ku e kur qëlloja me disa shokë të tij, të cilët i njihja dhe unë. Bënim muhabet të përditshmërisë, por kurrë nuk e merrnim temën e luftës. E shihja këtë djalosh që nuk donte të hynte fare andej... "Lufta është kryer. Ka kush merret me të. Ua lëmë historianëve... Tash e kemi jetën përpara, tjetrën luftë...", thoshte ai. Por, këtë herë do i shkruajmë pak fjalë për babën e tij. E, kush ishte babai i tij? Ishte një emër, i cili, sidomos në vitet 70, ishte personazh për të cilin shkruanin pothuajse të gjitha mediumet e Kosovës, por edhe të ish-Jugosllavisë, madje edhe disa ndërkombëtare. Ai emër ishte Shkëlzen Zhubi. Ishte njeri i artit. Gjithkund i dalluar. I veçantë. Edhe si valltar, edhe si koreograf. Edhe si skenarist, edhe si regjisor. Edhe si piktor, edhe si shkrimtar, por edhe drejtor i Ansambllit "Shota", i njohur edhe përtej kufijve, nga fitoi shumë shpërblime edhe ndërkombëtare. Ishte drejtor i shtëpisë së atëhershme të rinisë "Boro e Ramizi". Regjisor i Televizionit të Prishtinës. Shumë shfaqje, manifestime të mëdha iu besonin punës e angazhimit të tij. Shkëlzeni ishte piktor i stilit të veçantë, por edhe unikat në Kosovë. Pikturat e tij u ekspozuan nëpër shumë galeri personale dhe kolektive, madje edhe në disa shteteve të Evropës. Po ashtu, u dallua edhe në veprimtari letrare, tek botoi disa romane e përmbledhje me poezi, tek i priti mirë lexuesi dhe kritika... E sot për sot, pse s'përmendet Shkëlzen Zhubi, për të cilin në disa periudha dinim të krenoheshim me punën e tij, me shpërblyerim që i sillte nga takimet, manifestimet e ndryshme?

*

Por, edhe shumë të tjerë nuk i përkujtojmë, i lëmë në harresë! Hë, pse rrallë përmendet, për të mos thënë fare, akademik Fehmi Agani, shtylla qendrore e LDK-së një dekadë të tërë?! Pastaj, aktorët e mëdhenj: Abdurrahman Shala, Shani Pallaska, Malo Gami, Ragip Loxha, Melihate Ajeti, Avdush Hasani e shumë tjerë... Shkencëtarët: Gazmend Zajmi, Ali Hadri... Këta nuk duhet të kalojnë në heshtje. Këta nuk meritojnë të harrohen.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

Dy simbolet tona kombëtare...



A më i vjetër është plisi a flamuri?

A e dini se sa i vjetër është plisi e sa i vjetër është flamuri ynë dhe i sati është sipas renditjes në botë?

HISTORIA E PLISIT


Historia e plisit lidhet me historinë autoktone dhe daton që nga koha pellazgo-ilire, e deri në ditët e sotme. Plisi në popull dhe krahina të ndryshme shqiptare thirret edhe me emra të tjerë, për shembull, kësulë, qeleshe, qylah, qylaf dhe është quajtur varësisht prej regjioneve banuese. Dhe, bashkë me gjuhën dhe traditat tona, plisi është simbol i identitetit kombëtar shqiptar, të cilin populli ynë e ka ruajtur me fanatizëm e krenari. Se plisi e vërteton më së miri lashtësinë tonë, tregon historiani Muhamet Rugova. "Sipas arkivave dhe dokumenteve që edhe sot ruhen në muze të shumta të

botës, plisi është përdorur ndoshta 2 mijë vjet p. e. s. Edhe Zeusi, që ishte zot i Olimp, paraqitet në fotografi dhe skulptura me plis në kokë. Edhe Akili shfaqet me plis në kokë. Edhe Hehtori, Odiseu e Afërdita shfaqen me plis në kokë... Plisi për ne, shqiptarët, ka rëndësi të madhe, meqë prezanton identitetin tonë kombëtar dhe autoktoninë tonë në këto troje ku jetojmë", thotë Muhamet Rugova.

HISTORIA E FLAMURIT

U ka shkuar, ndonjëherë, mendja se cili është flamuri më i vjetër në botë? Flamuri më i vjetër në botë është ai i

Skocisë, i cili daton që nga viti 832 pas Krishtit gjatë një beteje. Më pas flamuri më i vjetër renditet ai i Austrisë, që nga viti 1230. Në vend të tretë renditet flamuri i Letonisë, i cili daton nga viti 1280. Në vendin e katërt shfaqet flamuri i Danimarkës, i cili daton nga viti 1307. Ndërkaq, në vendin e pestë, si flamuri më i vjetër, renditet flamuri ynë, flamuri shqiptar, i cili daton nga viti 1443. Dalja e parë e flamurit shqiptar ishte më 28 Nëntor 1443, kur Skënderbeu, hero i kombëtar, ngriti flamurin e tij mbi fortesën e Krujës, në kundërshtim me turqit që sunduan vendin. E, më 28 nëntor 1912, kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë, flamuri ynë u njoh zyrtarisht.



“Në luftë nuk kam shkuar që të pasurohem, por as kështu nuk jetohet!”

Ish-ushtari i UÇK-së nga Podujeva, Vehbi Tahiri, jeton i vetëm në barakat e këtij qyteti dhe me gjendje të rëndë ekonomike...

Gruaja i vdiq para një viti e gjysmë, fëmijë nuk ka.

Vehbiu thotë se baraka, në të cilët jeton tash e 20 vjet, nuk i plotëson kushtet për jetesë.

Thotë se ka bërë kërkesë në komunë për t'ia ndërtuar një shtëpi, por deri më tash kërkesa e tij nuk është marrë parasysh...

“Gruaja më ka vdekur para një viti. Bëj jetë në barakë qe 20 vjet. Komuna nuk më ka ndihmuar asgjë. Jam pa strehë, jetoj vetëm”, thotë ai.

Veterani i UÇK-së, i cili luftoi në zonën e Llapit, thotë se pensionin që e merr nuk i mjafton për ndërtimin e shtëpisë.

“Pensionin e veteranit e marr, por

tjetër shteti nuk më ka ndihmuar. Për momentin kam nevojë për një shtëpi, kërkesën e kam bërë në komunë”, thotë ai, me dhembje në shpirt, shkaku i gjendjes së rëndë ekonomike. Vehbiu thotë se pavarësisht mundësive që ka pasur për të jetuar jashtë Kosovës, është kthyer për ta çliruar vendin, por asnjëherë nuk ka menduar se do të jetojë në barakë...

“Unë nuk kam menduar që vijnë gjërat kështu. Në luftë nuk kam shkuar për pension, se nuk e kam ditë a do të shpëtoj gjallë a jo. Kam ardhur prej Maqedonisë në luftë, kam pasur mundësi me shkua jashtë, por jam kthyer me luftua”, thotë ai.

Për Vehbiun ëndërr dhe dëshirë ishte

vetëm liria e atdheut, për të cilën luftoi deri në ditën e fundit të çlirimit nga okupatori serb.

Mirëpo, pas lirisë ai u përballë me një jetë tepër të rëndë, i papunë, madje pa shtëpi...

Ai thotë se politikanët në Kosovë kanë menduar vetëm për vete...

“Gjërat po dihen, politikanët po mendojnë veç për veti, ka shumë familje që jetojnë në kushte të rënda, e jo veç unë. Qeveria duhet me i pa kushtet tona, për me na bërë një zgjidhje”, tha ai.

Ish-veterani i UÇK-së, Vehbi Tahiri, shpreson dhe u bënë thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi, që t'i ndihmojnë në ndërtimin e një shtëpie...



Në valutën e Kosovës: *Rugova, Thaçi a Kurti?*



*Mirë që nuk e kemi paranë tonë! Mendi-
met e njerëzve për figurat
dhe sim-
bolet që do
figuronin në
kartëmoned-
hat tona do
të prodhonin
shumë debate
të nxehta,
ndodha edhe
grushte...*

Po ta bënim valutën tonë, më të vjetrit e politikës sonë në Kosovë nuk do e përjash-tonin figurën e presidentit të parë, Ibrahim Rugova. Ai do e kishte vendin e merituar në valutën tonë kombëtare, nëse ajo do ishte në qarkullim ndonjëherë. Dhe, kah më lindi ideja për këtë temë? Të shtunën, teksa me shokë të Redaksisë pinim kafënë e mëngjesit, në tavolinën pranë, disa njerëz debatonin në këtë temë. "Eh, po temë e qëlluar!", them. Burimi i kësaj teme kishte rrjedhë nga një debat në një radiostacion tonin. Sipas tyre, një grua nga Dukagjini kishte thënë se në valutën tonë, të Kosovës, do kishte dëshirë të ishte figura e legjendarit Adem Jashari. Por, ajo, krahas Adem Jasharit, dëshironte të ishte edhe figura e Vjosa Osmanit e Albin Kurtit... Një telefonues kishte thënë se po të ishte ai që vendos për këto figura, në kartëmoned-

hë do kishte vënë Ibrahim Rugovën. Por, po të bënim kartëmonedhën tonë, të Kosovës, pa dyshim, do kishte edhe emra të tjerë, bie fjala, Hashim Thaçi. Mirëpo, për përcaktueshmërinë e figurave për kartëmonedha, propozimin, në radhë të parë, do duhej ta jepnin ekspertët e historisë për çdo figurë dhe, pastaj, Parlamenti, si organi më i lartë, do vendoste. Sigurisht me debate të nxehta, sepse secili do anonte kah përcaktimi politik... E, ndoshta do kishte edhe grushte... Sidoqoftë, Kosova ka figura me rëndësi që do i vendoste në kartëmonedhën e saj po të ndodhte një gjë e tillë, sepse shumë njerëz tanë kanë dhënë shumë për lirinë e Kosovës... Pa dyshim, nuk do duhej të lireshin anash as kompleksi memorial i Jasharajve në Prekaz, kompleksi memorial në Reçak, kulla e Tahir Mehës, kulla e Ahmet Delisë, e shumë të tjera...

S. Krivaça



Bujrum myshteri,
produktet e Kosovës në
Molla Markt i ki!!



Molla Market me shije të vendlindjes!



Atdhetar dhe fetar i devotshëm, hoxhë Jonuz Zejnullahu, nga fshati Skifter i komunës së Vitisë, ra dëshmor në pikën kufitare në Koshare, më 6 maj 1999, te vendi “Rrasat e Koshares”.

U bë “Mic Sokoli i Dytë”, meqë u hodh mbi bunkerin e pjesëtarëve të forcave speciale serbe, të quajtur “Snajperistët e specializuar”, ku vrau të pestët që operonin me snajperë speciale deri në disa kilometra rreth tyre.

Hoxhë Jonuz Zejnullahu, pasi hipi mbi bunker, duke aktivizuar bombat, e ku i asgjësoi serbët, arriti të largohej mes plumbash, duke u qëlluar nga shumë sosh dhe përfundoi në duart e shokëve të tij, për të vdekur gjatë rrugës për në spitalin e qytetit Bajram Curri, në Shqipëri.

Vite më parë, fshati Skyfter i komunës së Vitisë, kishte një burrë që u shërbente në oda e xhami, në rrugë e shtëpi, me ide çlirimtare. Ai, në odat e Anamoravës, ishte bërë zë lirie, duke i dhënë prioritet luftës çlirimtare dhe UÇK-së.

Në oda e xhami, ai predikonte ligjërime patriotike, veçmas dy vjet para lufte. E përshkruante gjendjen në Kosovë si nevojë për luftë çlirimtare.

Hoxhë Jonuz Zejnullahu, pak vjet para lufte, kishte diplomuar në Medresenë



Hoxhë Jonuz Zejnullahu - ushtari UÇK-së

Kush është “Mic Sokoli i Dytë” i Kosovës?

“Alaudin” në Prishtinë. Pas diplomimit ishte kthyer në vendlindje për t’i shërbyer popullit për çështje fetare e kombëtare. Ai u bë imam i xhamisë në fshatin Drobesh të Vitisë. Drobeshjanët, që arritën ta njihnin më mirë, e ngritën hoxhën në qiell, në një dokumentar kushtuar hoxhë Jonuz Zejnullahut.

Dokumentari televiziv “Hoxhë Jonuz Zejnullahu - legjendë e luftës çlirimtare”, tregoi më së miri për trimërinë e hoxhës nga Skyfteri i Vitisë, kundër forcave serbe në Koshare...

ARRESTIMI I HOXHË JONUZIT

Hoxhë Jonuzi mori pjesë aktive në demonstratat e organizuara në Viti kundër regjimit të Serbisë, konkretisht Millosheviqit.

Dhe, mu për këtë veprimtari, ai u arrestua disa herë nga policia serbe në vitin 1988, të cilin e kërcënuan edhe me likuidim fizik.

Axha i hoxhë Jonuzit, Deliu, thotë se Jonuzi, qysh si fëmijë, dallonte shumë nga të tjerët, sidomos në aspektin patriotik. Dhe, duke treguar për luftën e shenjtë të hoxhë Jonuzit kundër forcave serbe, vëllai i tij, Muhameti, përshkruan bastisjen që iu bë të vëllait në shtëpinë e tij në Skifteraj dhe kërcënimet që ia bëri komandanti i Njësisë Speciale të Policisë në Viti, Dragan Arizanoviq.

“Po vazhdoje kështu si deri më tash, do ta djegim objektin e xhamisë!”, e kishte kërcënuar kryepolici serb.

E, hoxha i ishte përgjigjur: “Nuk do arrish ta djegësh xhaminë kurrë!”.

Hoxhë Jonuzin tri herë policia e Gjilanit e kishte arrestuar në shtëpinë e tij dhe e kishte kërcënuar me vrasje.

Por, hoxhë Jonuzi u shpëtoi kërcënimeve që nga momenti kur u bë ushtar i UÇK-së. U stacionua në Koshare dhe mori pjesë në thyerjen e kufirit Kosovë- Shqipëri, ku edhe u hap korridori shqiptaro-shqiptar

dhe lëvizja e lirë e ushtarëve të UÇK-së në të dy anët e kufirit.

Babai i hoxhë Jonuzit, Qazimi, sa ishte gjallë, e kishte shëruar pikëllimin për vrasjen e të birit me lindjen e nipit, katër muaj pas vrasjes së të birit në Koshare...

NË SHTËPI LA VAJZËN TETË MUAJSH, GRUAN SHTATZËNË, E VETË SHKOI NË UÇK

Zhvillimet e luftimeve në Kosovë bënë që ai i dha lamtumirën e fundit shtëpisë dhe u nis në frontin e luftimeve në Koshare, duke kaluar fillimisht në Shqipëri, ku bëri ushtrimet e nevojshme ushtarake, për të kaluar më vonë në frontin e luftës në Koshare, ku edhe u luftua fytas me policë e ushtarë serbë...

Bashkëshortja e tij, Makfirja, në shtëpinë e saj, tregon me dëshmi lidhjen e bashkëshortit të vet me strukturat e organizuara të UÇK-së.

Derisa në Anamoravë nuk ishte ndezur lufta, ai ishte në lidhje me Drenicën. Ajo tregon notesin në të cilin ai kishte mbajtur shënime kontaktesh me njerëz të rëndësishëm dhe numrat e tyre të telefonit.

Notesi ishte i mbushur me emra njerëzish dhe numrat e tyre të telefonit, e të cilët i shërbenin çështjes patriotike në shërbim të atdheut. Në shumë faqe të notesit shënimet ishin në gjuhën arabe, me qëllim që të mos i deshifronte çdokush...

I pajisur me virtyte të larta të lirisë dhe drejtësisë dhe i pajisur thellë në shpirt me vullnet për liri, hoxhë Jonuzi ditën që u nis për në luftë i tha gruas se ajo ishte e obliguar të kujdesej për fëmijët dhe të bëhej nënë e mirë për ta...

Bashkëshortja, Makfirja, kujton momentin kur doli burri i saj nga shtëpia...

"Kujdesu për vajzën dhe bëhu nënë e mirë!", më tha.



Kompleksi memorial
i hoxhë Jonuz Zejnullahu

"Do të jem e tillë!", ia ktheva.

Aso kohe e kisha vajzën, Mirsadën, tetë muajsh, e që tash është në klasën e tetë, kurse në bark e kisha djalin, i cili lindi pak muaj pas vrasjes së babait të tij në Koshare, e të cilin e pagëzuam me emrin e babait të tij, e që babanë e njeh nga fotografia në murin e sallionit të shtëpisë dhe nga fotografitë e albumeve të shumta nga koha e shkollimit të tij në Prishtinë.

E njeh babanë e vet edhe nga busti në oborrin e shkollës fillore të fshatit tonë", thotë ajo.

Vlen të theksohet se i biri i dëshmorit të kombit, Jonuz Zejnullahu, është kopje e babait të tij...

Thotë se dëshira e tij është të bëhet arkitëkt i famshëm...

Ç'THOTË MYFTIU I KOSOVËS, NAIM TËRNAVA, PËR JONUZ ZEJNULLAHUN?

Në dokumentarin kushtuar hoxhë Jonuzit dhe rënien e tij në Koshare, myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, e kujton dëshmorin e kombit, Jonuz Zejnullahun, qyshkur ishte nxënës...

"Ishte nxënës që shkonte edhe përtej programit mësimor, duke pyetur se deri kur do të jetojë populli shqiptar i Kosovës në vuajtje, meqë Zoti thotë se të gjithë njerëzit lindin të lirë, e ashtu edhe duhet të jetojnë, të lirë", thotë myftiu Tërnavë. Ai i kujton edhe disa momente të tjera gjatë shkollimit të Jonuzit në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë, meqë Jonuzi dallohej nga të tjerët edhe për nga zgjuarsia dhe virtytet e larta humane, fetare e patriotike...

Në fshatin e lindjes, në Skifter, hoxhë Jonuzin e kujtojnë si njeri që rrallë lind për nga burrëria dhe me virtyte të larta njerëzore.

E, kjo bëri që ai të rreshtohet në Brigadën 138 "Agim Ramadani".

Ç'THONË SHOKËT E TIJ TË LUFTËS?

Shokët e tij të luftës, por edhe komandanti Rustem Berisha, e quan hoxhë Jonuz Zejnullahun "Mic Sokoli i Dytë".

Hoxhë Jonuzi bëri atë që nuk e kishte bërë askush deri atëherë. Shkatërronte bunkerët e forcave armike, e që ishin fortifikuar në vende që vështirë vëreheshin...

Hoxhë Jonuzi, në luftimet e datës 3 maj 1999, ndërmori aksion për sulm mbi bunkerët e forcave serbe, të cilët nuk lejonin avancimin e ushtarëve të UÇK-së në frontin e luftimeve.

Rrëfimi i komandantit Fadil Hadërgjonaj, për luftimet në dokumentarin kushtuar hoxhë Jonuzit, thotë:

"Armiku e shihte çdo ditë se ne rriteshim në numër. Dhe, krahas kësaj rritjeje ushtarët serbë fortifikoheshin nëpër bunkerë. Përmes bunkerëve serbët e kishin të vetmen mundësi ta ndalonin depërtimin e UÇK-së në hapjen e korridorit të nevojshëm. Serbët, në këtë mënyrë, synonin t'i mbanin pozicionet e veta. Ishte nevoja që bunkerët të eliminoreshin dhe të avancim drejt qëllimit final. I vetëdijshëm se vetëm kjo ishte mundësia që të fitohej beteja, hoxhë Jonuzi mësyu bunkerët serbë. Ai u ofrua pak metra pranë tyre dhe hodhi bomba dore në dy bunkerët e parë. Në këtë luftë bombash, hoxhë Jonuzi e fitoi luftën në të dy bunkerët, duke i vrarë ushtarët serbë.

Kishte mbetur vetëm bunkeri i tretë serb ende aktiv...

Hoxhë Jonuzi, duke mos pasur zgjidhje tjetër, hidhet edhe mbi bunkerin e tretë serb, duke aktivizuar dy bomba dore, me ç'rast vrau snajperistët që ishin brenda në bunker.

Por, me këtë rast, ai plagoset rëndë, por nuk mbeti në duart e forcave serbe. Arriti të largohej nga bunkeri dhe të bjerë në duart e bashkëluftëtarëve të vet, të cilët e nisën shpejt për në spitalin e qytetit Bajram Curri.

Sipas shokëve të vet, e që ishin me të, ai kishte marrë plagë të rënda në gjithë abdomenin dhe ishte larë në gjak...

Dhe, gjatë rrugës për në Bajram Curr, hoxhë Jonuz Zejnullahu ndërroi jetë, duke lënë pas vetes moral të pasqorë ushtarak, për çka edhe mori epitelin "Mic Sokoli i Dytë".

Andaj, hoxhë Jonuzi, i rënë në aksionet e UÇK-së, emrin e të cilit e mban shkolla e mesme në Viti, sipas zyrtarëve të lartë të Medresesë "Alaudin" në Prishtinë, dha shembullin më të mirë se si vdiset për atdhe. Hoxhë Jonuzi, pas rënies heroike, është bërë edhe personazh i shumë këngëtarëve, ndër të cilët edhe i Shkurte Fejzës, me këngën "Në emër të Zotit për liri".

Safet Krivaça



Busti i dëshmorit
hoxhë Jonuz Zejnullahu



Lum shqiptari si Nasim Haradinaj!

Nasim Haradinaj, luftëtar i UÇK-së në Koshare, e komplotoi profilin e tij me deklarata bombastike në Hagë, pa iu trembur syri fare...

Deklaratat e Nasim Haradinajt, njeri që tha të vërtetën për luftën e UÇK-së, bën që ai t'i fitojë zemrat e shqiptarëve anë e kënd Kosovës, diasporës dhe trojeve shqiptare, në përgjithësi. Ai nuk e fshehu të vërtetën se ka vrarë ushtarë dhe policë serbë në frontin e luftës. Ai e mbrojti UÇK-në si strukturë që ka luftuar në përputhje me rregullat e luftës.

Nasim Haradinaj, në seancën para Gjykatës Speciale në Hagë, i ka lënë gojëhapur të pranishmit në gjykatë me guximin prej luftëtari, duke mos fshehur asgjë nga lufta...

Shembulli i mbrojtjes dhe deklarave të Nasim Haradinajt për luftën e UÇK-së, duhet t'u shërbejë të gjithë të

akuzuarve dhe të dyshuarve që janë dërguar dhe që mund të dërgohen në të ardhmen në këtë gjykatë, kryesisht politike.

Ai, duke folur për luftën në Koshare, e që njihet si lufta më vdekjeprurëse frontale në Kosovë, është mbrojtur, duke thënë të vërtetën e luftës në këtë pjesë të Kosovës...

Nasim Haradinaj e ka kundërshtuar dhe e ka akuzuar Gjykatën Speciale për provokime të qëllimshme, e që e krahasohen me ato të juristëve serbë, që kanë bashkëpunuar me Gjykatën e Dhomave të Specializuara në Hagë.

Ai foli për shumë detaje të panjohura për publikun, duke shpalosur se një

pjesë të rritës së tij e ka kaluar në burgjet serbe, lidhur për radiator, duke u rrahur nga policët serbë.

I lindur në Dukagjin, prej nga edhe e trashëgon patriotizmin familjar, Nasim Haradinaj ka treguar se është kthyer nga diaspora për të luftuar kundër forcave serbe, e "jo për t'u dhuruar lule"... Edhe në debate publike gjithnjë ka qenë debatues që i thotë gjërat hap-tazi, pa maskë...

E, ajo që e bën Nasimin edhe më të adhuruar është fakti se ai gjithnjë i ka thënë dhe po i thotë gjërat me sinqeritet.


Andaj, lirisht mund të thuhet, lum shqiptari si Nasim Haradinaj...

S. Krivaça

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze


Vendndodhja:
**Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de

Si e vrau “përbindëshin” që vriste shqiptarë dhe si u vra vetë?

Avni Elezaj dy herë e tronditi Pejën: Herën e parë kur vrau Vidosmir Shalipurin, në prill të vitit 1999, i njohur si kryeçetniku malazez dhe, herën e dytë, kur u vra vetë në një shkëmbim zjarri pasluftë me grupet e armatosura në Pejë.

Avni Elezaj, djalë me zoll mbi kraharor, i doli në pritë kryekriminelit Shalipur te “Ura e Drinit”, në Jabllanicë të Vogël të Pejës. Dhe, pasi e vrau, ia preu kokën, të cilën ia futi në thes, për ta bindur shtabin e UÇK-së se e kishte vrarë kryepolicin, i cili i tmerronte shqiptarët. Fotografia e Anvi Elezajt qëndron në përmendoren e madhe në hyrje të fshatit Jabllanicë të Vogël të Pejës...



Avni Elezaj

SI ARRITI TA VRISTE KRYEÇETNIKUN?

Vidomir Shalipuri, xhudist i njohur, e që fuqinë e kësaj shkathtësie e zbrazte mbi shqiptarët, viteve të fundit paralufte i kishte tmerruar shqiptarët me sjelljet e tepruara kriminale, megjithëse shqiptarët e Pejës e dinin se edhe atij do i vjen fundi, meqë zulumi këputet prej së trashit...

Vrasja e Shalipurit, megjithatë, donte strategji dhe guxim, sepse kushdo që do i dilte në pritë, duhej ta dinte se kishte para vetes një "përbindësh", e që kurrë më parë nuk kishte pësuar asnjë shpullë nga shqiptarët. Ai kishte deklaruar se "s'kishte pushkë që e vret!".

Përveç shkathtësisë në xhudo, Vidomir Shalipuri kishte edhe gradë të lartë policore në policinë e Pejës, që e kishte fituar mbi "meritat" e dhunës mbi shqiptarët...

Banorët e Pejës tregojnë se ai e ndalte veturën e policisë në rrugët e Pejës dhe bënte xhudo, ndërkaq veturat duhej të prisnin derisa ai bënte qejf... Atë e hasje kudo: në treg, në kafene, në lokale nate, në qytet, në shkolla, shtëpi shëndeti, në spital...

Ai me ekipin policor në Pejë, formoi njësitin famëkeq, të quajtur "Çetat e Metohisë", me seli në Pejë, me qëllim të terrorizimit të popullatës shqiptare të kësaj ane e më gjerë.

Çetat e Shalipurit vepronin si njësi të veçanta në rajonin e Pejës dhe më gjerë dhe, sipas nevojës, shtriheshin në gjithë Kosovën...

Dhuna e njësiteve të Shalipurit ishte legalizuar nga policia e shtetit serb. Kriminelët serbo-malazezë ishin të lirë të bënin ç'donin mbi shqiptarët.

Prandaj, ishte vepër madhore vrasja eventuale e tij në Pejë, akt i cili pastaj do kishte represalie me hakmarrjen e shtetit mbi popullatën...

Ç'THONË DËSHMITARËT?

Në kohën kur intervistua disa dëshmitarë, ndër ta edhe Ymer Brahmin, i cili aso kohe ishte 56 vjeç, nga Novosella e Pejës, thotë:

"Nuk kishte njeri në Pejë që nuk e njihte Shalipurin. Ishte kryepolic, i graduar për dhunën që ushtronte mbi shqiptarët. Ishte një antishqiptar i përbetuar, i cili e zbatonte ndjenjën

antishqiptare me dhunë brutale.

Ai shpesh shihej në fshatrat shqiptare të Pejës me plis të bardhë në kokë, duke kënduar këngë çetnike, duke ofenduar këdo që haste, e të tjera".

Ndërkaq, Xhemë Sadri Elezaj, 55 vjeç, nga Jabllanica e Vogël e Pejës, falënderonte Zotin që dikush, më në fund, do e ndriçojë sado pak rastin e nipit të tij, Avni Elezajt, që vrau kryekriminelin Shalipur, epror i lartë policor në stacionin e Pejës.

Të dy akterët sot janë të vranë: Shalipuri nga dora e Avni Elezajt, ndërsa Avni Elezaj nuk dihet nga kush u vra paslufte...

Një portret i madh i Avniut, në ballë të odës së axhës Xhemë, qëndronte i varur dhe binte në sy, posa hyn në derë të odës.

Xhemë Sadri Elezaj, për vrasjen e Shalipurit, thotë:

"Shtëpia e familjes së vëllait është e zbrazët, meqë askush nuk jeton aty. Të gjithë janë jashtë Kosovës. Avni u vrau kryeçetnikun, Vidomir Shalipurin, që kishte marrë guxim të rrihte këdo nga shqiptarët që donte. Jeta ishte bërë e padurueshme nga ai...

Nipi im, Avni, ishte vetëm 17 vjeç kur u bë pjesëtar i UÇK-së. Ai bëri atë që nuk e bëri kush tjetër - vrau Shalipurin".

Dhe, teksa flet axha Xhemë, bashkëshortja e tij, Raba, herë-herë e plotëson me ndonjë fjalë...

"Askush nuk e kishte idenë se ai do ta bënte atë trimëri, e që mori pietetin e heroit të Pejës", tregon Raba dhe vazhdon:

"Ka qenë data 8 prill 1999, kur në Pejë u përhap si rrufeja lajmi për vrasjen e Shalipurit. Ne ishim në shtëpi me shumë të tjerë, e që synim kishim shkuarjen në Mal të Zi, në Rozhajë, që atëherë konsiderohej rrugë shpëtimi. Nuk e kemi ditur se Avni me shokë e kishin zënë pusinë të "Ura e Drinit", në hyrje të fshatit Jabllanicë e Vogël. Shalipuri, teksa kalonte me xhipin e tij të madh, Avni me zoll në krah i kishte dalë para dhe e kishte vranë Shalipurin, si në film...

Dhe, nuk kishte ikur nga vendi i ngjarjes. E dinte se nuk ishte e mjaftueshme vetëm ta vriste kryeçetnikun më në zë të kësaj ane, por Shalipurit

të vdekur ia kishte prerë kokën. E, kokën e tij e kishte shti në thes, që ta dërgonte në shtabin e UÇK-së në Studenicë, si dëshmi".

AVNIU NUK KRENOHEJ ME LUFTËN E BËRË...

Xhemë Sadri Elezaj, duke përshkruar karakterin e nipit të vet, Avniut, shpalos detajet e burrërisë së hershme të nipit 17-vjeçar...

"Avni ka qenë modest. Edhe pse u bë i famshëm, kurrë s'ka folur për të bëmat e veta dhe heroizmat që me gjasë kanë qenë të shumtë për një djalë të moshës së tij...

Ndonëse ishte në front, kurrë s'ke dëgjuar duke folur për diçka të madhe. Ka qenë pjesë e Zonës Operative të Dukagjinit. Ai thoshte se nuk ka shkuar në luftë për Ramush Haradinajn, as për Hashim Thaçin, as për Ibrahim Rugovën, por për lirinë e Kosovës.

Të vetmen gjë që nuk mund ta fshehte ishte gëzimi i madh për vrasjen e Shalipurit...

Dhe, pas vrasjes së Shalipurit, e dinim se policia e ushtria serbe do të hakmerreshin mbi neve, popullatën. Dhe, kjo ndodhi...

Në eufori të urrejtjes, u thyen postbolloqet në fshat, të cilat i kishte ngritur UÇK-ja...

Hapësira nga Novosella e deri në Jabllanicë ishte mbushur me njerëz që kërkonin të iknin për në Mal të Zi. Po atë ditë janë vranë Rexha i Radavcit, Ismail Veseli dhe tre të tjerë nga Dubova, si dhe Idriz Zeneli, i sëmure prej vitesh në shtrat.

Dhe, disi arritëm të dilnim në Rozhajë... Mezi i kam nxjerr të gjallë vëllanë tim, Ismailin, si dhe babanë e Avniut për në Mal të Zi, e që e shpëtuam kokën duke dhënë para...

Avni është vranë më 12 tetor të vitit 2002, në orën 19.30, te stacioni i trenit në Pejë. Nuk dihet kush e ka vranë, e as pse është vranë...

Në atë aksion kanë mbetur dy të vranë, secili në dyert e veturave të veta.

Babai i Avniut, Ismaili, është vranë më 17 mars 2004 në Pejë, por as për këtë vrasje nuk dihet gjë", thotë axha Xhemë, në fund të bisedës sonë, për legjendën nga Peja, Avni Elezajn.

Safet Krivaça

“Më merr malli edhe për therrat e Prelezit”!



Pamje e fshatit Prelez

Ditë më parë mora një telefonatë nga im kushëri, Imriu, që jeton në vendlindjen tonë.

Dhe, pasi më pyet, si zakonisht, si je, ç'bën e të tjera të ngjashme, më thotë se vëllai i tij, Shabani, kishte ardhur nga Zvicra para vitit të ri në Prelez dhe se nesër do të kthehej nga ka ardhur.

Por, siç më tha ai, ka dëshirë të vijë te ti, të të shoh, të të takoj. Veçanërisht kur ka vite që nuk jemi parë...

Dhe, natyrisht, i pres në shtëpi, meqë në kafene nuk bëhet biseda si në

shtëpi, asnjëherë...

E, taksa pimë kafe, bisedojmë për familjet tona, hallet tona, dertet tona...

Madje, edhe për ndërprerjen e rrymës elektrike, meqë ato ditë më shumë s'kishte rrymë sesa që kishte...

Dhe, kur i them “Shyqyr Zotit që ti je jashtë me familje dhe nuk i ke dertet tona”, ma ktheu:

“Rrymë kemi, punë kemi, vetura kemi... Por, më merr malli për Kosovën, për Prelezin, për therrat e Prelezit!”

Eh, kushëri, i them, më mirë të të merr malli për therrat e Prelezit sesa ne që

jetojmë me ato therra e na shpojnë verë e dimër...

Dhe, e lëmë këtë muhabet për therrat dhe kalojmë në politikë. Por, edhe me politikë punët po na shkojnë pus, andaj s'ka mbetur të bisedohet as për këtë temë...

Gjithsesi, tema më me interes dhe gjithmonë aktuale mbetet ajo familjare, kujtimet nga fëmijëria, edhe pse skamje kishte sa të duash, por dashuri e afri ndaj njëri-tjetrit kishte më shumë se kurrë...

I. ILAZI

Modele: Miesere Skenderi - Missi

BOOM

Miesere Skenderi
- Missi

vulos suksesin në
fushën e së bukurës

5 çiftët
e famshëm shqiptarë
që kanë diferencë
të madhe në moshë

Politikanë, këngëtarë
e sportistë që e provuan
martesën dy herë

Don Xhoni
mbetët pa para,
shet veturën!

Pse Fifi
u zhgënjye nga
puthja e parë?

Miesere Skenderi - Missi

vulos suksesin në fushën e së bukurës

Për Miesere Skenderin, e njohur si Missi, viti 2022 ka nisur mbarë dhe me shumë punë e angazhime në sferën profesionale, ku ajo është mjaft e njohur.





Missi është ndër profesionistet e rralla të fushës së bukurisë dhe estetikës. E njohur nga klientela për punën e saj profesionale, e cila prezantohet në faqen e saj Beauty By Missi në “Instagram”, Missi nuk ndalet së punuari me kujdes, korrektësi dhe delikatesë, por edhe me metodat më të reja dhe të avancuara të fushës. Miesere Skenderi-Missi ka kryer shkollën e rrobaqepësisë, ndërkohë që gjithmonë i ka interesuar estetika, ku edhe punon prej vitit 2017, duke bërë punë që konsiderohet me një cilësi të lartë. Të gjitha kurset dhe trajnimet i ka të kryera në Zvicër. Beauty By Missi konsiderohet e veçantë edhe shkaku se nuk i përton asnjë punë dhe asnjë angazhimi në salonet mjaft të njohura. Ajo punon me produktet më të mira dhe cilësore, për çka edhe veçohet...

Missi ofron këto shërbime:

- * Phi Lashes Artist
- * Phi Brows Artist
- * Powder Brows Artist
- * Nails Artist
- * Lashliftin Artist
- * Phi Brigit Microneedling Artist

MISSI ORGANIZON KURSE PROFESIONALE PËR QERPIKË

Siç mësojmë, ajo po merret, kryesisht, me kozmetikë dhe qerpikë dhe po mbanë kurse vikendi për ato që duan të mësojnë gjithçka rreth mbjelljes dhe trajtimit të qerpikëve.

Profesionistja e dëshmuar e qerpikëve, Miesere Skenderi, thotë se ka shumë të interesuara për kurs, për të mësuar të gjitha teknikat më të avancuara të punës me qerpikë, ndërkohë që ato mbahen në “NK Studio”. E, sa i përket informacioneve të tjera, ato mund të merren online përmes faqeve (i shihni në foto) në Instagram.

D. H.

Pasi u dështoi martesë e parë...

Politikanë, këngëtarë e sportistë që e provuan martesën dy herë

45 për qind e martesave, sipas një studimi, janë të destinuara të dështojnë. Është me fat ai i cili nuk bën pjesë në këtë përqindje. Disa lumturinë e kanë gjetur në martesën e dytë. E, nga ta ka edhe VIP-a që janë martuar dy herë. Cilët janë?

VALON BEHRAMI

Pas 12 vjetësh bashkë, futbollisti shqiptar u nda nga bashkëshortja e tij, Elena Bonzani. Nga martesë e tyre çifti ka dy vajza. Behrami u martua për herë të dytë me skiatores zvicerane Lara Gut, muaj më vonë.



EDI RAMA

Në kohën kur ishte pedagog në Akademinë e Arteve dhe piktor i njohur, aktorja bukuroshe ia rrëmbeu zemrën.

Por, Rama dhe aktorja Makoçi u ndanë në vitin 1991 dhe fryt i dashurisë së tyre është djali i tyre Gregor.

Me Linda Bashën u martua në vitin 2010. Nga martesë e tij me Lindën erdhi në jetë djali i tyre, Zaho.



GENA

Dy herë, gjithashtu, është martuar edhe këngëtari shumë i dashur për publikun, Gena. Martesë e tij e parë ka qenë shumë vjet më parë dhe nga ajo martesë Gena ka dy vajza.

Në martesën e dytë, me Lorenen, është qe dhjetë vjet, e që ka rënë në dashuri në shikim të parë.



EDONA LLALLOSHI

Vite më parë, këngëtarja e njohur, ka qenë e martuar. Edona deklaroi ndarjen, meqë martesë nuk funksionoi.

Gazmend Fejzullahu është bashkëshorti i ri, me të cilin në vitin 2010 Edona u shfaq në publik. Çifti janë prindër të dy fëmijëve.

JEHONA SOPI

Me vëllanë e Teuta Selimit, Agromin, ka qenë e martuar këngëtarja Jehona Sopi. Por, kjo martesë shkoi drejt divorcit. Jehona është e martuar prej vitesh me Lavdim Koshutovën, me të cilin ka një vajzë.



SABRI FEJZULLAHU

Sabriu ka qenë i martuar me një tjetër grua, me të cilën kishte dy fëmijë. Më pas ai u martua me Nerën, me të cilën, gjithashtu, ka dy fëmijë.

Nderim Neziri

Pse Fifi u zhgënjye nga puthja e parë?

Fifi është pa komplekse dhe e thotë troç atë që mendon. Troç flet edhe për ndjenjat, emotionet dhe zhgënjimet në dashuri. Këngëtarja tregon se deri në vdekje do të bëjë çdo gjë për dashuri...

Dashuria e parë?

- Dashuria ime e parë ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e jetës sime dhe ai është babai im.

Puthja e parë?

- Super zhgënjim!

Në dashuri ia vlen të ngulësh këmbë?

- Në dashuri nuk ia vlen të ngulësh këmbë, sepse një njeri që dashuron është në gjendje ta kthej botën përmbyse!

Cila është strategjia e joshjes?

- Nëse mund të them strategji, kohëve të fundit po përdori gjënë time më të shenjtë dhe të veçantë që kam - muzikën.

Çka përdor për të joshur: pamjen, trurin, humorin?

- Truri dhe humori janë specialitetet imi.

Shqisa më e rëndësishme në dashuri?

- Nuk dua ta marr në kuptimin e parë fjalën shqisë, sepse dashuria është më shumë se shqisë, është e shenjtë.

Dashuri me shikim të parë?

- Besoj në dashurinë me shikim të parë.

Seksi e pasuron dashurinë apo e kundërta?

- Të bërit dashuri e pasuron dashurinë...

5 çiftët e famshëm shqiptarë që kanë diferencë të madhe në moshë

Shpeshherë diferenca në moshë bëhet debat kur bëhet fjalë për personazhet publikë. Pse ndodh kjo?



ALKETA VEJSIU

Alketa Vejsiu e ka mbajtur gjithnjë hermetike jetën private dhe foto të saj me bashkëshortin nuk ka. Por, moderatorja shumë e dashur për publikun ka diferencë në moshë me bashkëshortin 15 vjet.

Alketa është 38 vjeçe, ndërsa bashkëshorti 53 vjeç. Alketa është njohur me bashkëshortin në moshën 19-vjeçare dhe janë prindër të dy fëmijëve.



ENI DHE GENCI

Eni dhe Genci Prelvukaj janë një nga çiftet më të komentuar, së fundi. Diferenca e tyre në moshë ishte çështja e parë që u diskutua kur u zbulua lidhja e tyre.

Genci është 40 vjeç, ndërsa Eni 25 vjeçe. Pra, çifti ka 15 vjet diferencë.

ANDRRA DHE SINANI

Andrra dhe Sinani është një nga çiftet më të dashur për publikun. Andrra është 26 vjeçe, ndërsa Sinani 46 vjeç. Pra, çifti kanë 20 vjet, por mosha nuk ka qenë pengesë në lidhjen e tyre, e cila u kurorëzua me martesë.

Andrra dhe Sinani janë prindër të një djali.



ARMINA DHE SHKËLZENI

Armina dhe Shkëlzeni janë prej vitesh në lidhje dhe së shpejti pritet të bëjnë edhe dasmën. Edhe ata janë komentuar shumë për diferencën në moshë, e cila është 14 vjet. Shkëlzeni është 45 vjeç, ndërsa Armina 31 vjeçe.

Megjithatë, kjo nuk ka ndikuar aspak në marrëdhënien e tyre dhe çifti janë shumë të dashuruar.




BLERO DHE AFRONA

Çifti i njohur i shou-bizit, e që dashurinë e kurorëzuan me martesë, Blero dhe Afrona kanë 14 vjet diferencë.

Blero është 44 vjeç, ndërsa Afrona 30 vjeçe.

Don Xhoni mbetët pa para, **shet veturën!**



Reperi i njohur nga Drenica, Xhonatan Isufi, i njohur si Don Xhoni, famën e arriti në një kohë rekord me freestylen e tij “Make a pose”, që u bë viral në rrjetet sociale gjatë kohës së karantinës.

Ai, së fundi, ka bërë një reklamë për njërin nga auto-sallonet, me ç’rast ka kërkuar blerës për vetura. Në një “Instastory”, të publikuar reperi në formë shakaje, ka thënë se ka mbetur pa koncerte dhe për këtë arsye kërkon blerës për veturën.

Shaka apo e vërtetë?





Ç’thonë prindërit e 13-vjeçares që u bë nënë?

“Një 13-vjeçare ka lindur vajzë, në gjendje të mirë shëndetësore në Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ç’thonë prindërit e saj?”

13-vjeçarja, Rr. H., nga Ferizaj, solli në jetë vogëlushen nga bashkëjetesa me një 16-vjeçar, me dijeninë e aprovimin e prindërve të të dy palëve.

Thonë se bashkëjetojnë me qejf, sepse dashurohen. Dhe, nga dashuria ka ardhur në jetë vogëlushja...

Familiarët e vajzës, të cilët jetojnë në kushte jo të mira ekonomike në Fushë-Kosovë, thonë se të dy kanë vendosur të bashkëjetojnë, sepse duhen, ani pse janë të mitur dhe për këtë gjë prindërit e të dy palëve janë pajtuar, meqë, sipas tyre, ndryshe do të ndodhte më e keqja, duke aluduar se fëmijët mund të pësonin...

Sipas tyre, vajza e ka braktisur shkollën. Partneri i saj, bashkë me babanë e tij, shesin hekurishte në Ferizaj, sa për të mbijetuar...



I burgosur në Goli Otok, i burgosur edhe në Shqipëri!

Shqiptari i Kosovës, Haki Hoxha, pasi i kishte mbajtur dy vjet burg në Goli Otokun e famshëm, i lidhur me pranga, ishte liruar si armik i Jugosllavisë.

Por, çka ndodhi tutje me të?

Më 22 maj 1959 kishte kaluar kufirin nga Jugosllavia për në Shqipëri me vëllanë dhe me disa shqiptarë të tjerë.

Dhe, pas qëndrimit në kampin e Shijakut 8 muaj, e dërgojnë në kampin e Semanit. E kishin ndarë edhe nga vëllai...

Por, duke kujtuar se “Enver Hoxha nuk dinte gjë”, ai kërkon ndërhyrjen e tij për të zgjidhur situatën. Nuk e kuptonte se çfarë gabimi kishte bërë që sillleshin kështu ndaj tij...

Megjithatë, Enver Hoxha nuk i kthen përgjigje, ndërsa më 24 qershor 1960, Llazi Stratobërdha linte shënimin se MPB-ja nuk ishte dakord të hiqej nga internimi, sepse kishte tendencë arratisjeje për në Jugosllavi.

“Në një roman të shkrimtares së njohur amerikane, Daniel Stil, Anën, teksa shëtiti buzë detit, rastisë ta prek në krah një burrë që vraponte në plazh. Kur ai ndalet t’i kërkojë falje, mahnitet nga bukuria e saj dhe i bën turr ta puthë.

Ajo i thotë:

“Ndal, ti as emrin nuk ma di!”.

“Ta mësoj më vonë...”, ia kthen ai.

Bëhu me banesë të re!



NORMA E INTERESIT

2.98%

**OFERTË
E LIMITUAR**



+383 49 50 90 90
www.cimaks.com

“Shqiptari me uniformë serbe ma vrau burrin!”

Muharrem Ibraj dhe Mushk Jakupi, nga fshati Osek Hilë, kryen krime ndaj shqiptarëve me uniformë të policisë serbe...

Në çdo moment Zahe Bajrami mundohet ta mbajë afër fotografinë e bashkëshortit të saj, të vrarë më 28 shkurt të vitit 1999. Atë ditë forcat serbe hynë në shtëpinë e tyre në Osek Hilë të Gjakovës, por vrasjen e bënë shqiptarët, të veshur me uniformë serbe. Kjo e rëndon edhe më shumë dhimbjen e zonjës së shtëpisë, e cila pa me sytë e saj, Mushk Jakupin dhe Muharrem Ibrajn, duke ia vrarë bashkëshortin. Është e rëndë për Zahe Bajramin të flasë për dhimbjen e madhe që kishte përjetuar mëngjesin e hershëm të 28

shkurtit 1999. Pothuajse i gjithë fshati Osekë Hilë i njihnin Muharrem Ibrajn dhe Mushk Jakupin, që u rreshtuan krah forcave serbe. Njëri nga ta që ishte rrahur, e që në atë kohë ishte nxënëse, rrëfen momentin kur ishte rrahur nga dy prej 200 policëve që kishte në dispozicion Mushk Jakupi. “Kalimi kësaj rruge ishte i pamundur pa u torturuar nga policët që i komandonte shqiptari me origjinë nga Gjakova, e që sot jeton në Serbi... Rrahje e maltretime përjetuan të

gjithë banorët, përfshirë këtu edhe nxënësit... Mushk Jakupi e Muharrem Ibraj kishin edhe bashkëpunëtorë të tjerë, të cilët për çdo mbrëmje i raportonin në detaje për ato që ndodhte në këtë fshat të Gjakovës. Dhe, përveç torturave kishin kryer edhe shumë vrasje të civilëve shqiptarë në atë kohë... Mirëpo, me hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë, ata u largohen nga Gjakova për t’u shpërngulur në Serbi ku jetojnë edhe sot”, thotë ish - nxënësi i rrahur.



Shkurt 2022

3⁺1
NETË FALAS

**E vlefshme
për 3 netë qëndrimi,
vetëm për ditët e javës!**





Pse malësorët *i vishnin rrobat mbrapsht?*

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, veçanërisht ndër banorët e zonave malore të veriut, mund të takoje në rrugë edhe njerëz me rroba të veshura së prapthi, madje në mënyrë të dukshme...

Veshjet mbrapsht, qëllimisht, përcillnin mesazhe të ndryshme, e që kishin të bënin me hidhërimin më të thellë dhe me gëzimin më të madh për familjen ose fisin. Veshja e gunës së prapthi ndër mir-

ditorët dëshmonte simbolikisht se personi mbante zi për vdekje mjaft të hidhur të një pjesëtari të familjes ose të një të afërmi në moshë të re, vdekje e cila kishte shkaktuar zbrazëti të madhe problematike për familjen, fisin dhe më gjerë.

Përgjithësisht, një mesazh i tillë përforcohej nga fytyra e ngrysur ose, siç cilësohej në disa krahina, “çehrrja e vrarë” e personit më gunë së prapthi. Në rrugët e krahinave fshatare mund të takoje edhe burra të veshur mirë, me fytyrë të qeshur, të cilët kishin veshur diçka së prapthi dhe, përgjithësisht, e ekspozonin këtë element të mbrapshtë.

Veçanërisht në krahinën e Kelmendit, një rrobë e tillë e veshur së prapthi nga një burrë, simbolikisht identi-

fikonte se ai në rolin e shkesit po shkonte të kërkonte dorën e një vajze për ta martuar me djalin e ndonjë të afërmi ose miku të tij.

Sipas një besëtytnie mjaft të përhapur ndër shqiptarët, në rrethana të tilla veshja së prapthi e ndihmonte shkuesin “t’i shkonte shkuesia mbarë”.

Kjo besëtytni ishte pjesë e një mendësie të përhapur gjerësisht në shoqërinë tradicionale shqiptare, sipas së cilës, në çaste të rëndësishme të gëzimeve vetjake e familjare, si lindja e fëmijës, fejesa, martesja, etj., duke kthyer diçka vetë së prapthi, personi në fjalë ose familjarët e tij i presin hovin vrullit të mbrapshtësive që mund të kërcënojnë jetën, harmoninë bashkëshortore, familjare etj.

LARGIMI

Unë po iki nga zori bir
Ti mos eja me mua
Mbaji mend gjurmët e mia
Mos i le t'i mbulojë pluhuri i Saharës
Kujdesu për ferkemtë e kohës
Kështu ndjejmë se nuk po vdesim

U nisa rrugës së huaj
Shatin ta vura në trarin e koshit
Fara pa mbjellë më mbeti
U nisa me duqe në shpinë
Jam për udhë
Ti mos eja me mua
Qëndro këtu-fol shqip

Po iki por jam një zog i këtij vendi
Ta dua therën time
Se dua degën e tharë të qyqes
Që këndon rremë më rremë
E s'ka atdhe

TY TA DHASHË NJË BESË

Ty ta pata dhënë një besë
Nuk di në është tamam
Atë që ma urove në jetë
Sot këtu e kam

Zemra jote donte më shumë, nënë
Por jeta s'jepte tjetër përveç lot
Sot arin e botës po ta kem
Me pandlën tënde s'e ndërroj dot
Kanë ikur kohë të lumtura
Me bukën e paktë që e kishim në dorë
Jetojmë me luksin e botës
Qajmë si ecnim zbatshur në borë

SHTËPIA IME

Atje larg afër një lumi
Ku buron kroi dhe uji
Atje kam unë një shtëpi
Ku ma lanë të parët e mi

Ma lanë shtëpinë amanet
Shko, më thanë, kjo të pret
Kjo fole ka shumë ngrohtësi
Të shuan mall, të jep dashuri

Veç atdheu e ka këtë diell
Ku uron lypësi i huaj
Vetëm këtu rritet çka mbjellë
Ku të rritë ajri dhe uji

NËNËS SË VETMUAR

Zbardhë dhe errët e vetme
Duke shprushur hirin
Në vatrën e mallit
Tek kallë zjarrin në oxhak
Mëngjes e mbrëmje
Me lot të ngrirë në qepallë
Aty ku ne u rritëm për të ikur në Evropë
Aty ku na gëlltisnin të huajt
Me një grusht krande në dorë
Kërkon ta shporrë vetminë
Ti dhe mallkimi jetoni bashkë
Zemra më doli vendit
Kur ti na kërkoje n'mes pemësh në oborr
Dhe ne e bëmë bukën dhe të gjitha
Por ne kurrë s'u bëmë më të lumtur s'e që ishim
E unë të thirra

Mendova se më vije pas
Tek shkoja n'mes rrugëve të botës
Të lashë vetëm me Zotin
Duke më thënë "Të ruajt Zoti"

MËRGIM A BURG

Sillem në këtë botë të egër
Ty të kurdisi Perëndia
Këtu erdhën pleq erdhën rinia
Ikëm nga luftërat
Zemra pikon gjak
Këtu ku jeta quhet drejtësi
Shpirti ngrinë nga padrejtësia

Ti vendi im je një këngë
E varur në sqep bilbili
Aty ku lumi ecën dhe ecën
E shpirti ka zjarr kandili

Por, hëna gjithnjë s'bën dritë
As dielli se ngrohë këtë botë
Në dhe të huaj kur je
Kërkon qetësinë në gotë

VERË E VENDLINDJES

Çdo ditë ikin stinët në mërgim
Unë me veten kam shumë grindje
Dal e shoh gjelbërim e lule
Por s'ka verë si në vendlindje

Fjalë e llafe që na i lanë
Sot këtu në kokë kanë mbet
Kudo qoftë që shkon në botë
Te ato kthehesh në jetë

Malli më qon sërish në oborr
Këmbëkryq ulur në huje të manit
Këngë të vjetra që qojnë peshë
Që t'i japim gjak vatanit

SHTRËNGATA

Fryn në Ballkan dhe bubullon
Fushë e male i trazon
Shqipet e kanë tokën dhe qiellin e vet
Historia nuk ka vdek'
Vazhdon të shkruhet me gjak
Vazhdon të jetohet shqip

S'është ky dimri i parë që prenë
Bar i ri do të mbijë përsëri
Ne do të vendosim lule mbi përmendore
Dhe do të bëhemi edhe më të fortë
Ta sundojmë botën
Nënat gatuan bukë për dëshmorët
Kohët s'presin bir
T'i ngulim gurët e rinj për megja të reja
Ta ruajmë gjuhën nga korbat
T'i rindërtojmë odat për histori
Toka e plisave të bardhë
S'duron gjuhë tjetër pos të shqipeve

MOS MË SHIKO

Nëse më prenë në besë
Tek ma thua një fjalë
Mos më shiko në sy

Nëse nuk të buzëqeshë
Mos ma merr për të keq
Shpinën mos e ruaj

Nëse nëna t'i vret kujtimet
Ti asgjë nuk ke harruar
I njeh ata që nuk kanë bukë

Nëse zemra të qanë
Sytë s'lanë nevojë për lot
Hape odën
Ofroje bukën për mikun

RRUGA

Mendova të mos nisem vetëm
I mbështjellë si në valë deti
Do kaloj male e male
Por këtu kush mbeti

Duke ecur në vetmi
Kujtoj brigjet e mia
Ç't'i thosha nënës kur dola
A do më pret shtëpia

S'kërkova lule kur ika
Kopshtin plot lule e lashë
Kërkova bukën e huaj
E më shtëpinë s'e pash

Malli më hanë çdo ditë nga pak
Por unë s'u bëra tjetër
U ktheva te kënga ime
Se gjeta shtëpinë e vjetër

VISET E MIA

Kur të vij një ditë nga rruga e ëndërruar
Do t'ua varros mallkimin
Do të bëheni të bekuar
Nga bukuria e pranverës
Do të rritemi së bashku
Do ta kërkoj pleqërinë kaçubë më kaçubë
Do të rrafshohen rrudhat
E do të mbetët fytyra si deti pa dallgë
Këtu do të flas me të parët
Vendi im është i vetmi ku lind dielli çdo agim
Dhe perëndon pas kodrës sime
Aty ku është fundi i botës

MALLKIMI

Mallkuar qoftë një histori
Që na e shkruajnë të tjerët
Shkuam në toka të huaja
Dukemi si të mjerë

Djemtë tanë në kurbet
Flasin gjuhë të huaj
Unë që Kosovën e kam frymë
Kjo më bën të vuaj

Gjuhë e nënës sime
Gjuhë e tokës sonë
Po vjen në majë të botës
Si nga deti Jon

Na ka ndarë Evropa
Na kanë prerë e vrarë
Na bëjnë të lotojmë
Nga atdheu të na ndajnë.

Ka njerëz që më donë edhe pa qenë e virgjër!

Shumë meshkuj mendojnë se femra nuk mund të dashurojë tjetërkënd pas “humbjes së virgjërisë”. Dhe, e tij do të jetë deri në fund të jetës... Shtrohet pyetja: A mendojnë njëjtë edhe femrat?

**BESËLINDA, STUDENTE
E VITIT TË PARË
NË FAKULTETIN
E GAZETARISË:**

“Jam në vitin e parë në fakultet. Që nga shkolla e mesme jam në lidhje me të dashurin tim, të cilit edhe ia kam falur virgjërinë në një nga ndejat tona.

Por, nëse silllet keq me mua, le ta dijë se nuk më intereson as virgjëria e as ai. Sepse, jetën time dua ta ndërtojë në bazë të mirëkuptimit dhe sinqeritetit.

Gjithmonë më thotë se më do, se do të jem vetëm e tij dhe e askujt tjetër... Por, që të jem e tij duhet tërë jetën të silllet mirë me mua, kështu siç bën

edhe tash. Përndryshe, ka njerëz të tjerë që më donë edhe pa qenë e virgjër”.

**DETJA, PUNËTORE
NË BUTIK:**

“Mendoj se shumë meshkuj mendojnë ta zhvirgjërojnë të dashurën e tyre me iluzionin se të njëjtën, pastaj, do ta kenë tërë jetën!

Por, unë, e që jam martuar verës që shkoi, po ta kuptoj se im burrë më ka zhvirgjëruar vetëm e vetëm që të martohem me të, do të ndahem prej tij sa më parë.

Virgjërinë ia kam falur, sepse e kam dashur dhe e dua dhe jo për pazare martesore”.

**VELINDA, PUNËTORE
ADMINISTRATE
NË KOMUNË:**

“Unë mendoj se femra shkon në shtrat me një mashkull jo për interes, por e shtyrë nga dashuria që ka për personin me të cilin është në lidhje.

Konkretisht, ende jam e virgjër, edhe pse jam në lidhje dashurie me një koleg timin të punës. Por, as unë e as ai nuk jemi të mendimit se duhet të bëjmë seks para martese. Së pari martesa e pastaj seksi, fëmijët... e të tjerat me radhë. Sepse, disa femra, në mesin e të cilave jam edhe unë, janë shumë të ndjeshme nëse lëndohen, përbuzën, maltretohen, tradhtohen...”

Diturie Haxhaj



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

“Mos më thirr në telefon se ta luaj nënë!”

Të dielën e parë të janarit, teksa po shkoja në drejtim të Mitrovicës, një femër ma bën me dorë në formë stopi në rrugë, afër fshatit Stanovc. Dhe, posa e ndala veturën, pa një e pa dy hyri në veturën time...

“Si je, o burrë? A je mirë? Si i ke në shtëpi? Si janë të gjithë? A po lodhesh? Çka po bën dhe nga po shkon?”, m’i tha të gjitha, pa pritur përgjigje...

“Jam duke shkuar në Vushtrri”, i them unë. “Të mora sepse po shkoj në drejtim kah po shkon edhe ti, si duket...”

“Në rregull, por unë tashmë jam e rritur dhe futem në cilën veturë dua!”, ma ktheu ajo.

“Aha, më vjen mirë, mos ma zë për të madhe se kam qëlluar paksa naiv e nuk i marr vesh këto sende shumë. Po, sa vjeçe je?”, ia kthej unë.

“Jam 22 vjeçe, e rritur”, më thotë.

“Ku shkon, ku e ke stacionin e fundit?”

“Stacionin e kam deri ku shkon edhe ti!”

“Nuk po kuptoj, më fal, ma sqaro më mirë këtë punë!”

“Shkoj ta pres një njeri”.

“Ti të presësh njeri, këmbë, a?!”.

“Po, me “Reno 2” do e pres dhe ai do vijë!”

“Mirë shumë”, i them unë, teksa ajo i përgjigjej një personi në telefon, duke i bërë titur pse po e shqetësonte ditë e natë.

“Mos më thirr ma në telefon se ta luaj nënën! Harroje këtë numër!”, i thotë, duke e sharë dhe bërë horë.

U FRIKOVA SE MOS PO MA LUAN NËNËN EDHE MUA!

“Ani, djalë i mirë, çka ka të re kah ti?”, më pyet si me ironi.

“Mirë është çdo gjë, por të reja nuk ka, krejt plaka!”, i them unë.

“Ani, a do të reja, pra?!”.

“Jo, faleminderit shumë, i kam bërë do vjet dhe i kam lënë këto punë, sepse duhet të ketë njeriu një stacion ku ndalet...”

“Ha-ha-ha, ti plak, a?!”.

“Po, për besë, shkoi jeta oj çupë, tash duhet të jetohet me fytyrë, e jo duke e humbur fytyrën!”, i them me krenari. Dhe, kur arrita te rrethi, në hyrje të Vushtrisë, pa një e pa dy, më tha: “A po ma ndal këtu veturën?”

“Po, si jo. Dhe, falë Zotit që po zbret!”, i them unë.

E ndali veturën dhe ajo pa më përshëndetur del nga vetura. Lirohem prej saj dhe marr frymë lirshëm. Lirohem nga një barrë që nuk më kishte ndodhur kurrë në jetë, edhe pse kam udhëtuar shumë...

S. Murturi

“

*Puthja e parë
as nuk di të jepet, as nuk di të merret,
as nuk di të fshihet.*

The logo for Walone Fashion Group features the word "walone" in a large, white, elegant serif font. The letters are closely spaced, with a distinctive design for the 'w' and 'l'. The background is a dark, textured surface with subtle, flowing patterns in shades of deep red and purple, creating a sophisticated and artistic feel.

walone

FASHION GROUP

WWW.WALONEFASHION.COM



Pse e vendosa fotografinë time **te njerëzit e vdekur?**

5400 vjet më parë, ai që ia fali trupin majës më të lartë të Alpeve, do të ketë thënë, në atë acar, se u ngjit atje që të vdiste për ta kujtuar gjithmonë. E, edhe unë, e kam vendosur fotografinë time, në vargun e fotografive të të vdekurve, për t'më kujtuar...

Shumë portrete njerëzish të vdekur ishin gozhduar në murin pranë varrezave dhe vargu i njerëzve për t'i parë ato ishte tepër i gjatë, aq sa mund të mendoje se nuk arriheshin dot t'i shikojnë të gjithë.

Disa foto dukeshin të vjetra, disa më të reja dhe bëheshin edhe më nostalgjike nga buqetat me lule shumëgjyreshe...

Nuk e kuptoja gjithë atë skenë njerëzish që kishin mësyre vizitën... Pas pak, kah unë vinte një zonjë me fustan të kuq dhe më tha: "A je ti në këtë foto?"

Dhe, pyetja më zgjoi kureshtjen, aq sa sytë i drejtova drejt gishtit të saj... E tunda kokën në shenjë pohimi... Për herë të parë e shihja veten të vdekur, duke qëndruar fotoja ime në

mur. Por, kjo nuk ishte edhe aq interesante për mua sa më bënte përshtypje zonja me fustan të kuq, e që e kisha parë diku, por nuk më kujtohej ku...

Po heshti, zonjë, - i thashë - sepse po mundohem të mendoj ku të njoh... Jemi pa diku... Të njoh edhe më parë...

Por, ku nuk po më kujtohet, meqë lufta, edhe pse kanë kaluar mbi 20 vjet, na e ka fshirë një pjesë të trurit...

"Unë po të bëj përshtypje më shumë se fotografia jote në mur, a?!", ma ktheu shpejt e shpejt.

"Po, madje shumë!", ia ktheva.

"O burrë, ti ke vdekur, e mendon në mua, a?!", më tha.

"Jo, nuk kam vdekur, por e kam vendosur foton në mesin e të vdekurve që t'më kujtojnë, meqë po harrohen njerëzit... Sepse, duhet të vdesësh për

të të kujtuar!

E, këtë fustan të kuq që e ke, më duket, se e kam prekur shumë herë me dorë gjatë kohë kur isha fëmijë! Por, po të mungon lulja në mes të fustanit!", i thashë.

"Është zhdukur lulja nga vjetërsia!", më tha.

Dhe, pak më larg shoh dy njerëz që bisedonin ndërmjet veti...

Burri me plis i fliste një të riu. Por, meqë ishin paksa larg, nuk dëgjoheshin fjalët. Nga hedhja me duar shihej se plakun mendohej ta bindte të riun...

Por, për çka, nuk mund ta kuptoja...

Megjithatë, vërehej se i riu i përkulej të moshuarit. Ndoshta ka bërë ndonjë mëkat dhe tash dëshiron ta përmirësojë gabimin...

S. M.



Classy, superior, exclusive, chic, elegant, high quality



/so__classy



Vajza që më deshi mua bëri vetëvrasje!

*Vajza të cilën e desha
në fëmijërinë time,
në moshën 16 vjeçe
deshën ta bënin nuse.
Por, meqë më donte
mua, nuk pranoi të
bëhej grua e tjetrit.
Dhe, në një ditë pran-
vere bëri vetëvrasje...*

Vajza që më deshi mua, në rininë e hershme, e pakënaqur nga jeta, e kapluar nga ëndrrat rinore, bëri vetëvrasje mu në atë pranverë kur donin ta martonin. Por, ajo nuk kishte menduar se aso kohe më vrau edhe mua në shpirt, sepse që nga ajo kohë e deri tash jetoj sa për të jetuar... Në çast, më luhat im bir dhe shpejt e shpejt më doli gjumi... "Ngrihu se ka ardhur jote motër nga Zvicra dhe po të pret në sallon...", më thotë. Dhe, kur hyra në sallon, ishte ajo, ime motër, që dikur, si simpatinë time të rinisë, e patën martuar me zor, në Zhegovc të

Gjilanit, vend malor ku as sorrat nuk jetojnë, meqë nuk kanë çka të hanë... "Isha në një gjumë të rëndë, motër... Në një ëndërr të keqe... Me një kujtim të keq... Ka kohë që nuk kam parë diçka të më të keqe... Pash në ëndërr njerëz të vdekur... Madje, edhe një që kurrë nuk dëshiroj ta shoh, sepse më bëhet sikur jam shkaktar i vdekjes së saj... Mirë që paske ardhur motër, e ndoshta ma largon pak atë mërzi që pata në ëndërr...", i them, më shumë për të ngushëlluar vetveten.

S. Murturi

“

*Toka është si gruaja,
jo që dallon nga fshati në fshat,
por dallon edhe brenda fshatit si me pëllëmbë.*

(Jakov Xoxa)



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;

- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;

- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;

- Tonifikim i thellë;

- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;

- Përmirëson sistemin nervor;

- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;

- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;

- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;

- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;

- Lehtëson gjendjen e depresionit;

- Efekt analgjektiv;

- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

- Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;

- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;

- Humbje të peshës;

- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;

- Relaksim muskolor, etj.

- Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

- Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.



Më la gruaja se nuk e lejoja të sillej rrugëve!

Jam një kurbetxhi i Gjilanit në Gjermani. Para dy vjetësh, kur isha për pushim dimëror në Kosovë, por edhe për t'u çmallur me familje, disa ditë i kalova në Durrës. Atje njoha një femër me emrin Genta. E ftova të pinim kafe në një lokal buzë detit dhe filluam të bisedonim me njëri-tjetrin për gjërat e kaluara: ajo të vetat e unë të miat. Dhe, përfunduam me martesë.

Menjëherë pas njohjes shkëmbyem numrat e telefonit për të qenë në kontakt me njëri-tjetrin. Kah mbrëmja ajo më dërgoi një mesazh që të takoheshim përsëri të nesërmen. Në sms më tha: "Në ato momente, kur isha me ty, ndjehesha e qetë dhe e lumtur, por kisha shumë emocione që të flisja hapur dhe lirisht, prandaj po të dërgoj këtë sms".

Unë iu përgjigja me sms se do të takoheshim përsëri të nesërmen e do të flisnim gjerë e gjatë e më hapur me njëri-tjetrin. Të nesërmen kështu ndodhi: ajo më mori në telefon dhe e lamë vendtakimin po te i njëjti lokal ku kishim pirë kafe. Kur arrita në lokal ajo veç ishte ulur në verandën e lokalit. E pyeta: "Ke shumë kohë që më pret?".

Ajo m'u përgjigj: "Gjysmë ore ka që kam ardhur".

Morëm piqe, pastaj biseduam gjerë e gjatë për çdo fushë të jetës. Më tha se i pëlqente të bënim një xhiro buzë detit dhe vazhduam të flisnim për dëshirat e jetës. Në një moment, ajo m'u drejtua me pyetjen: "Çfarë të pëlqen më shumë te një femër

që preferon të bëhet gruaja jote?"

Iu përgjigja se më pëlqen thjeshtësia, sinqeriteti dhe të jetë e edukuar. Ajo më pa në sy dhe tha: "Do ta dish realitetin e jetës sime? Të intereson?"

"Po, dua të di realitetin tënd", i thashë.

Ajo nisi t'më tregonte një histori dashurie që e kishte zhgënjyer dhe filloi të qante. Në atë moment i hodha dorën në qafë dhe vazhdova t'ia fshija lotët. Ajo m'u afrua e më dhuroi një puthje që më la pa fjalë. Puthja e saj më bëri që të ndjeja dashurinë që po hapte derën e zemrës sime. Më pas vazhdova ta puthja pa pushuar derisa i thashë: "Më jep pak kohë të mendohem". "Të falënderoj për sinqeritetin që ke e po tregon ndaj meje!", ma ktheu.

PO VIJ ME TY NË GJERMANI!

Dhe, pas një jave, kur edhe duhej të kthehesha në Gjilan, sepse më ofrohej koha për t'u kthyer në Gjermani, më tha: "Më merr edhe mua me vetel".

Më në fund, shkova në shtëpinë e saj. U gëzuan kur më panë të familjes së saj.

Biseduam gjerë e gjatë dhe ramë në ujdj që ajo të vinte me mua në Gjermani. Por, pas një viti bashkë, ajo filloi të tregojë "fytirën" e saj të vërtetë. I pëlqente jeta rrugaçe, e që mua një gjë e tillë më nevrikoste shumë...

Dhe, kur pa se asgjë nuk kishim të përbashkët, një ditë, kur u ktheva nga puna, nuk e gjeta në banesë. Numrin e telefonit e kishte kthyer në postë, për të mos lënë gjurmë që ta gjeja.

I telefonova familjes së saj se mos ishte kthyer në Shqipëri dhe ata m'u përgjigjën se nuk ndodhej as në Shqipëri dhe se nuk u kishte telefonuar fare, se kishin një muaj pa ia dëgjuar zërin.

Pas gjashtë muajsh të ikjes së saj, teksa kthehesha nga puna, një mbrëmje, pash Gentën. Nuk u besoja dot syve të mi...

Ajo më shikonte se çfarë do t'i thosha në atë moment. Mendova ta ofendoja, por nuk e bëra një gjë të tillë, sepse nuk isha i interesuar për një femër rrugaçe, por për femër që do më bëhej grua dhe do krijoja familje...

V. Rrahimi

Më thuaj çfarë shenje je, të them ç'ves ke!

Askush nuk është i përkryer. Pa dyshim, keni edhe vese negative...

DASHI

Personat e kësaj shenje nuk mendohen dy herë për të blerë diçka që ju pëlqen dhe shpesh shpenzojnë më shumë seç duhet. Nëse doni të hiqni dorë nga ky "ves" mendoheni më gjatë para se të blini diçka.

DEMI

Demat njihen për kokëfortësinë e tyre dhe mospranimin e gabimeve. Për të mos pasur këtë problem mundohuni të luani më shumë rolin e njeriut paqësor dhe ndaloni së provuari të tjerëve se e kanë gabim.

BINJAKËT

Personat e kësaj shenje janë gjithmonë shpirti i festës dhe kalojnë shumë kohë duke festuar apo luajtur. Duhet ta kuptoni se jeta është shumë e bukur edhe nëse ndiqni një ritëm normal dhe nuk shpenzoni më shumë energji seç duhet.

GAFORRJA

Gaforret e kanë të vështirë të dalin nga zona e tyre e komfortit dhe u pëlqen të rrinë gjithë kohës mbyllur në shtëpi. Mundohuni ta ndjeni më shumë efektin e natyrës dhe do të kuptoni se edhe bota jashtë është e bukur.

LUANI

Luanët kanë dëshirë të shpenzojnë gjithë paratë e tyre në firma të shtrenjta. Përpara se të blini diçka superluksoze, mendoni se ka alternativa të tjera dhe mund ta merrni produktin e preferuar me çmim më të lirë.

VIRGJËRESHA

Personat e kësaj shenje ndjekin pothuajse gjithmonë të njëjtën linjë kur vjen puna tek veshjet. Mundohuni të provoni trende të reja dhe të dilini jashtë rregullave të zakonshme.

PESHORJA

Femrat e kësaj shenje janë shumë të fiksuar në makeup, sepse pëlqejnë që sytë e tyre, në përgjithësi, të dalin në pah. Provoni të shfaqeni pa grim, sepse edhe me këtë formë do dukeni bukur.

AKREPI

Akrepat i pëlqejnë shumë ngjyrat e forta dhe, kryesisht, të errëta, e që përshtaten edhe me karakterin e tyre misterioz. Duhet të provoni diçka tjetër dhe, në këtë mënyrë, as njerëzit nuk do të "tremben" nga ju.

SHIGJETARI

Këta persona kanë gjithmonë dëshirë për të udhëtuar në vende të ndryshme të botës dhe shpesh përhumben në mendimet e tyre aventureske. Duhet të gjeni diçka që t'u sjellë më shumë rregullsi në jetën tuaj.

BRICJAPI

Bricjapët ndonjëherë tregohen kopracë dhe blejnë vetëm gjërat bazike, që ju nevojiten në jetë. Nuk është problem nëse shkoni në një dyqan, provoni dhe blini, të paktën, njëherë diçka me çmim të shtrenjtë.

UJORI

Këta persona nuk bëjnë asnjëherë plane dhe gjithmonë i marrin vendimet në bazë të situatës në të cilën ndodhen.

PESHQIT

Peshqit janë persona shumë të ndjeshëm dhe gjithmonë shkaktojnë drama. Duhet të hiqni dorë nga ky ves dhe të filloni t'i shikoni gjërat ndryshe.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Jetoj pa shpresë!

E dashura magjistare, më ka rënë fati të bie në një familje jo të mirë, ku gjoja morali trajtohet shumë e nuk lënë gjë pa bërë vetë! Prej kur ja martuar nuk kam pasur lumturi. Nuk kam afërsi me burrë. Më dhemb i gjithë trupi... Çka më pret sivjet?

“Fati i mallkuar”

Përgjigje:

Ti ke pësuar, sepse në kohën e njohjes me tënd burrë, problemin e ke zgjidhur me zemër, e jo me kokë.

Gjërat kanë shkuar deri këtu ku janë sot dhe tani çka duhet bërë?

Ti duhet të jesh korrekte dhe ta mbash nivelin tënd. Ke kryer fakultet, por je bërë nuse e një burri që s’e ka as shkollën e mesme, madje! Shoh se sivjet do të jetë për ty një kthesë familjare, sepse do të kaloni për të jetuar në banesë dhe shumë prob-

leme që rrjedhin nga familja e gjerë do të zgjidhen gradualisht...

Dashuri me gruan e huaj...

Përshëndetje zonjë! Jam lexues i rregullt i rubrikës tënde...

Në mua ka rrjedhur diçka që po më brengos shumë. Para tre muajsh u dashurova në një grua të huaj, që jeton afër meje. M’u duk se askush nuk do ta bënte të madhe këtë punë, por ajo i tregoi burrit të vet dhe kështu situata u komplikua... Ç’të bëj që të qetësohen gjërat?

“Drenasi”

Përgjigje:

Ajo çka duhet të bësh është kërkim-falja dhe qëndrimi në distancë me atë familje, sepse secila afërsi, qoftë edhe rastësi, mund të sjellin probleme fizike.

I shoh gjërat keq për të dy palët, sepse pala tjetër është shumë e mllëfosur dhe shoh se ka pasur probleme edhe zonja që i je ofruar, edhe pse nuk ka pasur hile.

Ajo i ka treguar burrit të vet, nga frika se ti nuk do largohesh prej saj dhe për asgjë tjetër...

E, pranimi i gabimit i lehtëson gjërat.

Lidhja me burrin e martuar maqedonas

Përshëndetje e nderuara magjistare, i kam shpresat e fundit te ti. Jam vajzë 27-vjeçare, jetoj në Tetovë. Jam serioze, e punësuar. Jam në lidhje me një burrë të martuar, maqedonas. E dua shumë, por edhe ai më do.

A do të kemi jetë të për-bashkët?

“Shpresa vdes e fundit”

Përgjigje:

Në rastin tënd, më mirë do të ishte të mos jesh fare serioze, sesa të jesh e tillë e je në lidhje me burrë të martuar, madje të kombit e fesë tjetër! E, kjo s’të falet assesi, sepse as familja jote nuk do të pajtohen me këtë budallallëk tëndin...

Andaj, mos prit prej tij asgjë, por brenda ditës jepi fund këtij budallallëku tënd!

A do të pajtohet familja që të fejohe me të dashurin?

Përshëndetje zonjë e nderuar, jam 21-vjeçare, jetoj në Gjermani. E dua një djalë që jetojmë në të njëjtin qytet, por nuk na lënë të fejohe mi dhe ta gëzojmë dashurinë ndaj njëri-tjetrit. Arsyeja pse nuk na lënë të fejohe mi është se prindërit tanë paskan pasur një zënkë para 11 vjetësh dhe është bërë mollë sherri që ne të vuajmë!
Çka do të ndodhë, a do të fejohe mi?

“Liza”

Përgjigje:

*Bashkimi juaj do t'i ofrojë dhe bashkojë edhe prindërit tuaj. Nëse nuk u lejojnë të fejohe mi, martohuni edhe pa lejen e tyre.
E, nëse dalin pengesa, ju jetoni në një shtet ku ligjërisht do ta njohin të drejtën tuaj për të jetuar së bashku...*

Kam nevojë për zgjidhje urgjente!

Jam 27-vjeçare, nga Zvicra. E dua një djalë në Zvicër dhe jemi pajtuar që të fejohe mi.
Por, problemi është se tash jam në pushim dimëror në vendlindje, në Gjilan. E, edhe këtu e kam dikë që

ende e dua...

Si të vendosi?

“Pa shifër”

Përgjigje:

*Këshilla ime është: Vendos me zemër! Fejohu me atë që e do më shumë!
Djaloshi që e do në Gjilan e di se ti e do edhe dikë tjetër në Zvicër, andaj sqaroje punën me të..
E, sa i përket atij në Zvicër, ai e di që ti e do edhe dikë tjetër dhe nuk të ka shkaktuar asnjëherë problem...*

A do të kem fat?

Jam vajzë 27-vjeçare, nga Prishtina. Kam të dashur, të cilin e dua shumë. Edhe ai më do. Por, e pengon fakti që nuk jam virgjine! Jemi bashkë që katër vjet, por nuk po mund të vendosim për fejesë...

Çka do të ndodhë me mua?

“Vali”

Përgjigje:

Duhet të marrësh vendim: Ose fejesë ose tërhiq!
E, nëse ai nuk do fejesë, orientohu në fat të ri...

Nuk e dinë se jam në lidhje me të dy!

Përshëndetje, jam vajzë, 23-vjeçare. Jam në lidhje me dy shokë, me të cilët dal ndaras.
I dua të dy, por duhet të

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

vendosi për njërin...

Si do rrjedhin gjërat?

“Loti”

Përgjigje:

*Gjërat do të rrjedhin ashtu që ti do të mbetesh pa asnjërin...
E, pse?
Sepse, kur ta kuptojnë për lidhjen tënde me të dy do të mbetesh pa asnjërin...*

Familje e pafat

Unë që u shkruaj jam F., nga Zvicra. I kam 5 fëmijë, por nuk po na shkon asgjë mbarë. Të gjithë na thonë se kemi magji. Kemi shkruar shumë kund, por nuk kemi gjetur zgjidhje.
A do të përmirësohet jeta jonë sivjet?

“E humbura”

Përgjigje:

Nuk keni magji, por fëmijët kanë vendosur lidhje të reja në shpejtësi dhe nuk e kanë gjetur veten te njëri-tjetri. Kjo tregon se puna është bërë me nguti. Megjithatë, ndarjet nuk janë fundi i botës. E, që ta ndryshoni gjendjen duhet ta lini pas shpine të kaluarën...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

www.sherwoodhotels.com.tr
+90 444 88 07